



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI B

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi natyror

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshtatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e saj, komisioni i vlerësimit këshillohet me drejtuesin teknik dhe specialistin e AVA për vlerësimin përfundimtar të pyetjes.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**MIGJENI****Recital' i malsorit**

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë

Pyetja 7 **2 pikë****Model përgjigjeje:**

Trajta të gegërishtes janë: grupi (ue) në fjalët: *e trazueme, e zgjueme, i vuejtjes*, përdorimi i (n) te fjala (të *pakënaquna*), fjala *ujën* etj.

2 pikë. Nëse jep dy trajta dialektore nga strofa e dytë ose dy fjalë po nga kjo strofë dhe shkruan trajtat në gjuhën standarde.

1 pikë. Nëse jep vetëm një trajtë dialektore ose vetëm një fjalë.

0 pikë. Nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 8 **1 pikë****Model përgjigjeje:**

Poetin me malësozin mund ta bashkojë:

- **vuajtja, dëshira për ngadhnjim, revolta, protagonizmi, trazimi shpirtëror etj.**

1 pikë. Kur jep njëzën nga përgjigjet e dhëna më lart.

0 pikë. Për përgjigje të gabuar ose kur nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 **4 pikë****Model përgjigjeje:**

a- Pjesa e ligjëratës është: **mbiemri**.

b- Formimi: **me prejardhje, me prapashtesim, genjeshtër + ar (tema fjalëformuese + prapashtesë)**.

c- Shpjegimi i ngjyresës që përftohet:

Vetë epiteti metaforik **thekson cilësinë** zhgënjyese të shpresës.

Ose

Ngjyrimi artistik është i lidhur me kuptimin negativ, që merr shpresa, e cila **e zhgënjën** çdo ditë heroin me mosrealizmin e saj.

Ose

Tashmë vuajtja është kthyer **në një shoqëruese të përditshme**, si të ishte miku, pjesëtari i familjes, prandaj dhe poeti i vesh asaj cilësimin e gënjeshtërs si të ishte njeri.

Ose

Ai e quan gënjeshtare, ngaqë **e dëshiron** atë shumë, zhgënjehet pa masë nga mosrealizmi i saj.

Ose

Brenda stlilemës përftohet një **kontrast i skajshëm**, që krijohet midis dy fjalëve: **shpresës dhe gënjeshtërs**.

Ose

Oksimoroni.

4 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigjet e pikës (a, b dhe një variant përgjigjeje të ngjashëm me pikën c).

3 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm përgjigjet e pikës (a, b) dhe bën një shpjegim jo të plotë të ngjyresës së epitetit metaforik /ose mund të japë të plotë ngjyresën dhe njëren nga përgjigjet e pikës (a ose b).

2 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm dy nga përgjigjet më lart /(ose vetëm (a dhe b) / ose vetëm njëren prej tyre dhe tjetrën, një përgjigje jo e plotë e pikës (c)/ ose vetëm përgjigje të pikës (b) dhe përgjigje jo të plotë të pikës (c)/ ose vetëm përgjigje të pikës (c) të plotë.

1 pikë. Nëse nxënësi jep njëren nga përgjigjet më lart (ose vetëm (a)/ ose vetëm (b), ose një përgjigje jo të plotë të pikës (c).

0 pikë. Për përgjigje të gabuar ose kur nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10**3 pikë****Model përgjigjeje:**

a- Tiparet që poeti i vesh malit janë:

(heshtja, indiferenca, frika, madhështia, etj).

Ja si paraqiten ato në shembujt e mëposhtëm nga poezia:

- mali **s'bëzanë**
- mali **qesh**
- mali **hesht**
- mali **dridhet**
- mali **ndërgjegjësohet për dobësinë** etj

b- Poeti i vesh malit tipare njerëzore:

- **për ta shpirtëzuar,**
- **për ta personifikuar,**
- për ta bërë atë të duket **si qenie njerëzore,**
- për të dhënë pengesën, që i vështirëson jetën malësorit.
- për të dhënë **pengesën dhe përballë tij malësorin si qenie ekzistenciale.**
- për të treguar që i kërcënohet **mbijetesa.**
- për t'i dhënë **gjallëri dhe forcë monologut** të malësorit.
- etj.

3 pikë. Nëse nxënësi jep njërin nga tiparet e pikës (a) dhe shpjegon qartë qëllimin e përdorimit të tij.

2 pikë. Nëse nxënësi jep tiparin dhe shpjegon pjesërisht qëllimin e përdorimit të tij ose bën një shpjegim të tiparit, megjithëse nuk e ka dhënë atë të veçantë në pikën a.

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm tiparin ose nëse bën vetëm një shpjegim jo të plotë të tiparit.

0 pikë. Nëse nxënësi nuk jep përgjigje sikundër më lart ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **3 pikë****Model përgjigjeje:**

- a- Figura e intonacionit poetik është: **pasthirrma**
- b- Shembulli: ***O, si nuk kam një grusht të fortë.***
- c- Heroi paraqitet: **i revoltuar, i paduruar, i pafuqishëm, ndien dhimbje për pafuqinë, i shqetësuar, i pakënaqur etj.**

3 pikë. Nëse jep të tri përgjigjet më lart

2 pikë. Nëse jep dy nga përgjigjet më lart.

1 pikë. Nëse jep vetëm një nga përgjigjet më lart.

0 pikë. Nëse jep përgjigje të gabura ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **8 pikë****Model përgjigjeje:****12/a Shtjellimi i idesë 2 pikë . Duhet të kihet parasysh:**

- Përqendrimi në temë, përshtatja me qëllimin e temës.
- Fokusimi në konceptin Mal dhe Malësor
- Depërtimi të mali figurativ, të vetvetja etj.
- Shtjellimi i lidhjes midis tyre: malit, njeriut, malësorit (lidhja mund të shihet të fortësia, madhështia, durimi, krenaria, pamposhtësia, revolta, vështirësia, kundërshtia etj.)
- Renditja e argumenteve të shtjellimi i kësaj lidhjeje (këtu nënkuptohet shpjegimi dhe mbështetja e mendimit me fakte, detaje).
- Përshkrimi konçiz i faktit mbi të cilin mbështetet argumenti, mendimi.
- Etj.

2 pikë. Kur ka treguesit e mësipërm.

1 pikë. Kur trajton temën përkatëse, por nuk përdor argumentin si element.

0 pikë. Kur nuk shkruan dhe argumenton në lidhje me temën, kur nuk kuptohet asgjë, ose nuk shkruan fare.

12/b Organizimi dhe struktura 2 pikë . Duhet të kihet parasysh:

- Pjesët përbërëse të esesë (hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Nëse përdor paragrafët si element kompozicioni ose nëse ka renditje të detajeve, fakteve etj.
- Kronologjia (rend të mendimit dhe ideve, fakteve, të shembujve që jep).
- Logjika (të ketë lidhje me çfarë është thënë më parë).
- Kalimet e kuptimshme (nga pjesa ose fragmenti të përmbledhja argumentuese).

2 pikë. Kur nxënësi realizon strukturën e mësipërme.

1 pikë. Kur respekton vetëm strukturën formale, por nuk demonstron cilësi në ndërthurjen e saj me kuptimin dhe argumentimin.

0 pikë. Kur nuk ka strukturë ose nuk shkruan fare.

12/c Stili dhe origjinaliteti . 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Shprehjet origjinale (fakte, detaje, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
- Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues (me rrjedhshmëri, me efekt bindës).
- Nëse ka qartësi.
- Nëse ka rend normal, të zhdërvjellët të fjalëve dhe fjalive (fjalët e renditura në fjali duhet të përcjellin kuptim dhe ngarkesë emocionale bindëse).
- Nëse stili është jo imitues, (të mbështetet te autori, por të japë dhe mendimin e tij).

2 pikë. Kur ka treguesit e mësipërm.

1 pikë. Kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.

0 pikë. Kur nuk thotë asgjë, ose nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

12/d Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) 2 pikë

Duhet të kihen parasysh:

- Trajtat e dhura e fjalëve.
- Fjali të sakta.
- Shenjat e pikësimit.
- Shkronja e madhe.
- Etj.

2 pikë. Kur nxënësi ka bërë një argumentim dhe punim brenda normave të mësipërme

1 pikë. Kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar.

0 pikë. Kur gabimet e shumta deformatojnë, ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

PJESA II**BALZAK****Evgjeni Grande**

Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	D	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë

Pyetja 20 **2 pikë****Model përgjigjeje:****Kuptimi mbi shprehjen mbështetet në këtë model përgjigjeje:**

a- Kjo shprehje është e lidhur me mendimin që ka plaku Grande mbi **vlerat njerëzore**. Sipas tij çdo gjë është në rregull kur ke para. Tashmë që Karlit nuk i ka mbetur më asgjë, plaku mendon se ai mund të **shfrytëzojë** Evgjeninë ose vetë atë, mund të **dëmtojë** pasurinë e tij, ose tani vetë plaku nuk e sheh më si më parë Karlin, si objekt nga ku **mund të përfitonte**, por si **një barrë**.

b- Plaku këtu del: **koprac, i pashpirt, i lig**, etj.

2 pikë. Kur nxënësi jep një shpjegim të thjeshtë për shprehjen, kur shpjegimi është i lidhur me fragmentin dhe nxjerr një tipar të plakut Grande.

1 pikë. Kur nxënësi jep vetëm tiparin ose vetëm shpjegimin për shprehjen.

0 pikë. Kur nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 **3 pikë****Model përgjigjeje:**

a. Shenja e pikësimit është: **reticensa, trepikëshi**.

b- **Shpjegimi:** trepikëshi nëkupton që Evgjenia ka frikë, nuk ka kurajo të përballet me të atin, nëkupton sjelljen arbitrare të Grandesë etj. Pranohen përgjigje të përafërta me këto variante, që janë të lidhura me kontekstin e fragmentit.

3 pikë. Nëse nxënësi gjen trepikëshin ose reticensën dhe shpjegon sipas mendimit të tij se çfarë nënkupton ajo, duke iu përshtatur kontekstit.

2 pikë. Nëse nxënësi jep terpikëshin dhe jep një shpjegim të pjesshëm të nënkuptimit.

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm trepikëshin ose vetëm një shpjegim të pjesshëm të nënkuptimit.

0 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22**1 pikë****Model përgjigjeje:**

Karli reagon kështu: *pa dëgjuar më fjalët e të ungjit, u lëshua me vrap nëpër oborr, ngjiti shkallët, hyri në dhomë, u plas në shtrat.*

Ose

Nxënësi mund ta thotë të perifrazuar: **u ndje keq dhe i vetmuar nga ajo që i tha ungji, nga lajmi i keq që mori, s'e mbajti veten, qau etj.**

1 pikë. Nëse nxënësi jep situatën duke e marrë atë nga fragmenti ose duke e perifrazuar me fjalët e tij.

0 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23**3 pikë****Model përgjigjeje:**

a- Fjalë të fjalorit të Grandesë janë:

flori, thesar, ar, pasuri, verdhushka, etj.

b- Shembuj fjalësh të urta:

Shpirti nuk blihet me flori.

Koha është flori.

Kush gjen një mik, gjen një thesar.

Ndonjëherë heshtja është flori, fjala argjend.

Jo çdo gjë që shkëlqen është ar etj.

3 pikë. Nëse nxënësi jep dy fjalë të përafërta me fjalën *para* dhe një fjalë të urtë mbi paranë, thesarin, floririn etj.

2 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm dy fjalët ose jep fjalën e urtë së bashku me një fjalë.

1 pikë. Nëse nxënësi jep njëren nga ato.

0 pikë. Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24**4 pikë****Model përgjigjeje:**

a- Pasojat shpirtërore të personazheve për shkak të *parasë* janë si më poshtë:

- Paraja plakun **Grande** e ka kthyer në **një koprac të pashpirt, ka tharë** tek ai çdo ndjenjë njerëzore. Paraja është pasioni i tij i vetëm.

- **Evgjenia** është një vajzë e ndjeshme, që **viktimizohet** nga pushteti i parasë.

- **Karli** ndien **dhimbje** për humbjen e të atit dhe jo për humbjen e pasurisë. Ose Karli në përballje me paranë e ruan ende ndjeshmërinë humane.

- **Znj Grande** gjithashtu është **viktimë e pasionit tiranik** të të shoqit për paranë. Është një hije në familje.

b- Zgjidhja e romanit paraqitet e tillë:

- Plaku Grande vdes “skllav”i parasë.
- Karli **zgjodhi paranë** dhe jo dashurinë.
- Evgjenia bën **një jete asketike**, ndjek **amanetin** e të atit. **Viktima e vërtetë është Evgjenia**. Ajo shuhet e vetme.

4 pikë. Nëse nxënësi jep pasojën për dy personazhet dhe interpretimin për fundin e romanit.

3 pikë. Nëse nxënësi jep dy nga personazhet dhe interpreton pjesërisht zgjidhjen.

2 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm dy pasojat e personazheve/ ose një pasojë dhe pjesërisht interpretimin/ ose vetëm shumë mirë interpretimin.

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm njërën nga ato që thamë më lart.

0 pikë. Nëse përgjigja nuk ka lidhje me kërkesën ose nxënësi nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25**3 pikë****Model përgjigjeje:**

a- Situata dramatike shkaktohet nga lajmi i **vdekjes së atit të Karlit dhe reagimit në familjen Grande dhe të pjesëtarëve të saj.**

Ose

Situata dramatike lidhet me përjetimin e thellë të Evgjenisë, kur kupton me ç’baba ka të bëjë.

Pika kulmore është vetë fjalia e fundit e fragmentit: - *të japësh falimenton*, - *ia ktheu i ati, është çnderimi më i madh midis gjithë çnderimeve të tjera.*

b- Shpjegimi :

Ky kalim ndodh duke e përgatitur lexuesin, **hap pas hapi**; fillimisht jepet lajmi i vdekjes së vëllait të Grandesë, më pas gjendja e Karlit, drama e Evgjenisë, që njohu natyrën e vërtetë të të atit, më pas Plaku Grande i shqetësuar, merret vesh falimentimi dhe në fund vlerësimi i Grandesë për falimentim.

Vetë fjalia e fundit e fragmentit është pikë kulmore: - *të japësh falimenton*, - *ia ktheu i ati, është çnderimi më i madh midis gjithë çnderimeve të tjera.*

3 pikë. Nëse nxënësi gjen situatën dramatike, identifikon pikën kulmore dhe shpjegon kalimin nga njëra te tjetra.

2 pikë. Nëse nxënësi jep të saktë vetëm përgjigjen e pikës (b)/ ose jep përgjigjen e pikës (a) dhe pjesërisht përgjigjen e pikës (b).

1 pikë. Nëse nxënësi jep vetëm përgjigjen e pikës(a) ose vetëm pjesërisht përgjigjen e pikës (b).

0 pikë. Nëse jep përgjigje që nuk ka lidhje me ç’i kërkohet ose nuk përgjigjet fare.